

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Zabeli kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Shaban Prekalla, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë, nga neni 327 par 2 nën par 2.7 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3347/2015, datë 19.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.3347/2015, datë 19.11.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.3347/2015, datë 19.11.2018, të akuzuarin E.M., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë, nga neni neni 327 par 2 nën par 2.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 2 (dy) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 € e shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate si dhe shumë prej 30 €, për kompensimin e viktimave të krimit, dhe atë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë. I dëmtuari S.A., lagjja “ ...”, rr.“ ...”, tek ..., Hyrja ..., nr. ..., Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e

ankimuar ta ndryshoj, ashtu që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv. Kundër kësaj ankesë, mbrojtësi i të akuzuarit av, A.H. ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që ankesa e prokurorit të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.79/2019, datë 14.02.2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ku i njëjti aktgjykim i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, Prokurori me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë gjatë matjes së dënimit ka vlerësuar të tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë lehtësuese ka marrë pranimin e fajësisë, pendimin e të akuzuarit si dhe faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor i ri edhe atë vetëm tre muaj më parë kishte mbushur 18 vjet, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla të ngjashme. Sipas ankesës së prokurorit gjykata e shkallës së parë për veç rrethanave lehtësuese tek i akuzuari nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, kështu që është e bindur se me dënimin e shqiptuar kundër të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht konform nenit 50 dhe nenin 41 të KPPK-së. Mirëpo, me ankesë Prokurori i Shtetit konsideron se gjykata e shkallës së parë, nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese ndaj të akuzuarit. Në realitet gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë shkallën e përgjegjësisë penale,

intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, sepse, po që se do ti vlerësonte këto rrethana rënduese e posaçërisht po që do të merrte për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale me siguri së dënimi i shqiptuar nuk do të ishte kaq i butë.

Sipas ankesës së Prokurori të Shteti, nuk është e mjaftueshme që i akuzuari të dënohet për veprën penale të vjedhjes së rëndë më një dënim kaq të butë sepse vepra penale e vjedhjes është vepër penale e një rrezikshmërie shumë të lartë shoqërore dhe me një dënim kaq të butë nuk mundë të arrihet qëllimi i dënimit. Po ashtu, prokurori në ankesën e tij thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në konsideratë faktin se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se me kryerjen e veprës penale do ti shkaktoj dëm të konsiderueshëm material të dëmtuarit S.A., e në të njëjtën kohë do të shkaktoj edhe ndjenjë të pasigurisë tek qytetarët e tjerë, duke pasur parasysh edhe gjendjen momentale se vjedhjet e rënda janë shpeshtuar në rajonin e Prishtinës. Gjithashtu i njëjti konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë në konsideratë as faktin se i akuzuari E.M., veprën penale e ka kryer në bashkëkryerje më të miturin G.B, prandaj, prokurori konsideron se ky dënim nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale ndaj të akuzuarit si dhe në qoftë se do të vlerësoheshin drejtë edhe rrethanat rënduese nga ana e gjykatës së shkallës së parë me siguri dënimi do të ishte më i lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të prokurorit për një dënim me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, sikurse janë rrethanat lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është penduar për veprën e kryer, se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor i ri si dhe faktin se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Pretendimet e Prokurorit për një dënim me burg efektiv, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se rrethanat e cekura në ankesën e Prokurorit si rrethana rënduese që nuk janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, kolegji penal i kësaj gjykate i vlerëson si elemente të veprës së kryer penale (dashja, bashkëkryerja,) paraqesin elemente të veprës penale e jo rrethana rënduese, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në

dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij, dhe do të ndikoj në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.57/2019, datë 22.02.2019

Zyrtari Ligjor,
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:
Shqipe Qerimi
Afrim Shala